



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2023:269729

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05753040

**PAKR.nr.272/2024**

**NË EMËR TË POPULLIT**

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, Departamenti i Krimeve të Rënda – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Vaton Durguti – kryetar i kolegjit, Bashkim Hyseni dhe Kadrije Goga Lubishtani - anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Syzana Goxhuli, në çështjen penale kundër të akuzuarit A.E, për shkak të veprës penale blerja posedimi shpërndarja dhe shitja e paaautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, duke vendosur lidhur më ankesën e Prokurorisë Themelore në Prizren si dhe ankesën e mbrojtësit të akuzuarit A.E, avokatit Gentian Krasniqi, të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.116/23, datë 14.03.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur konform dispozitës së nenit 390 të KPPK-se, me datë: 28.05.2024, mori këtë

**A K T G J Y K I M**

**APROVOHET** ankesa e Prokurorisë Themelore në Prizren, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren- Departamenti i Krimeve të Rënda, PKR.nr.116/23, datë 14.03.2024, **NDRYSHOHET** përkitazi me vendimin mbi dënimin, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarin A.E për veprën penale për të cilën është shpall fajtor e Gjykon me dënim me burgimi në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj, i cili do të ekzekutohet pasi aktgjykimi ta merre formën e prerë, ndërsa dënimi me gjobe në shumë prej katërqind (400) euro merret si i vërtetuar, në pjesën tjetër aktgjykimi mbetet i pa ndryshuar.

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.E, av.Gentian Krasniqi.

## A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren - Departamenti i Krimeve të Rënda, me aktgjykimin PKR.nr.116/23, datë 14.03.2024, të akuzuarin A.E për shkak të veprës penale blerja posedimi shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve substancave psikotrope dhe analoge nga neni 267 par.1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Në pajtim me nenin 44 të KPRK-së, me pëlqimin e akuzuarit dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve zëvendësohet me dënim me gjobë dhe atë në shumë prej 1000 € (njëmijë euro), si dhe me dënimin me gjobë në lartësi prej 400 € (katërqind euro).

Në pajtim me nenin 76 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK-së, të akuzuari i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në lartësi prej 1400 € (njëmijë e katërqind euro), i cili dënim duhet të paguhet në 5 (pesë) këste nga 280 € (dyqind e tetëdhjetë euro) në muaj dhe atë në fillim të muajit prej 01-08 të muajit vijues, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Nëse dënimi unik me gjobë nuk paguhet në afat ligjor i njëjti do të zëvendëset me 70 (shtatëdhjetë) ditë dënim me burgim, ashtu që për çdo 20 € (njëzetë euro) të dënimit unik me gjobë do të zëvendësohet me 1 (një) ditë burg.

Të akuzuarit në pajtim me nenin 267 par.5 të KPRK-së, i konfiskohet substanca narkotike dhe atë: 10 (dhjetë) qese najloni të mbushur me substancë narkotike të llojit marihuanë, me peshë totale neto prej ..... gram si dhe 1 (një) pako me rizlla "...", pasi që janë mbajtur në kundërshtim me ligjin në fuqi.

Në pajtim me nenin 113 të KPP-së, telefoni celular i tipit ".....", me numër serie R58M571ZMMA, së bashku me një futrrollë me ngjyrë të zezë i kthehen pronarit – akuzuarit, pasi që nuk ka bazë ligjore për konfiskimin e tyre.

Është obliguar i akuzuari të paguaj shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë së gjykatës, në emër të paushallit gjyqësor duhet të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), ndërsa në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit të paguaj shumën prej 50 € (pesëdhjetë euro), të gjitha këto në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë kanë ushtruar

Prokuroria Themelore në Prizren, për shkak të vendimit mbi dënim, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykim e ankimuar ta ndryshoj përkritazi dhe të akuzuarit ti shqiptoj dënim me ashpër me burg dhe gjobë për veprën penale të kryer.

Mbrojtësi i të akuzuarit A.E, av.Gentian Krasniqi, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2 pika 2.1 dh 2.7 në lidhje me nenin 242 Par.2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPPK-së, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, ta refuzoj ankesën e prokurorisë në tërësi si të pa bazuar, ta aprovoi ankesën e mbrojtësit në tërësi si të bazuar dha ta anuloj aktgjykim e ankimuar dhe lëndën ti kthehet gjykatës së shkallës parë në rigjykim dhe rivendosje.

Prokuroria e Apelit me parashtrësën, PPA/I.nr.254/2024, datë 08.05.2024 ka propozuar që të aprovohet ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të akuzuarit ti shqiptohet një dënim me i lartë me burgim dhe me gjobë, se sa në aktgjykimin e ankimuar, kurse ankesa e mbrojtësit të akuzuarit A.E, av.Gentian Krasniqi të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit e caktoj dhe e mbajti seancën e kolegjit në pajtim me dispozitën e nenit 390 të KPPRK-së, në të cilën morën pjesë, mbrojtësi i të akuzuarit A.E, av.Gentian Krasniqi, kurse Prokurori i Apelit dhe i akuzuarit Albion Elshani edhe pse janë njoftuar në mënyrë të rregullt nuk morën pjesë në seancë. Gjatë seancës mbrojtësi i të akuzuarit mbeti pranë pretendimeve të parashtruara në ankesë, me propozim që ankesa e PTH-së të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit i shqyrtoi shkresat e lëndës, studioj aktgjykimin e kundërshtuar konform dispozitës së nenit 394 të KPPRK-së dhe pasi që vlerësoi pretendimet ankimore në ankesa gjeti se:

Ankesat e Prokurorisë është e bazuar, ndërsa ankesa e mbrojtësit nuk është e bazuar.

Prokurori në ankesë thekson se gjykata e shkallës së parë në rastin e shqiptimit të dënimit ka pasur parasysh rrethanat lehtësuese të cilët ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, duke mos përmendur fare rrethanat rënduese, edhe pse në rastin konkret kemi të bëjmë me substanca narkotike të llojit marhuanë që klasifikohen me rrezikshmëri, qarkullimi dhe shitja e të cilave është e ndaluar në Kosovë, po ashtu nuk përmend edhe faktin se substanca është gjetur në automjetin e tij dhe atë të vendosura në dhjetë qese të najlonit, si dhe një pako me rizlla .....

Sipas prokurorisë me rastin e shqiptimit të dënimit pa varësisht këtyre fakteve dhe rrethanave rënduese të akuzuarit, i është shqiptuar dënimin me gjobë në shumë simbolike si dhe dënimin me burgim duke zëvendësuar me gjobë, kurse rrethanat rënduese përkundër faktit se ato ekzistojnë gjykata atë nuk e përmend në arsyetimin përkitazi me vendimin mbi dënimin. Andaj në raport me veprën penale që e ka krye i akuzuari A.E dënimi është nën minimumin e parashikuar me Kodin Penal dhe konsiderohet tejet i butë meqë në shumicën e rasteve si përdorues i narkotikëve të llojit mariuhanë pëson brezi i ri shkollor, rinia dhe në shumicën e rasteve nga përdorimi i tyre përfundojnë edhe me fatalitet. Ka shtuar se mungesa adekuate e dënimeve të shqiptuara nga ana e gjykatës ka si pasojë dëmtimin e vlerave e që është jeta dhe shëndeti i të rinjve e që ka për obligim gjykata me e mbrojtur përmes dënimeve të ashpra me burg për shitësit e narkotikëve po ashtu dënimi duhet të ketë efekt parandalues që kryerësi por edhe të tjerët mos të kryejnë vepra të këtilla ose të ngjashme penale, kështu që konsiderojmë se shqiptimin e dënimit kaq të butë nuk do të arrihet qëllimi i dënimit.

Tutje ka shtuar se gjykata me rastin e shqiptimit të dënimit me burgim nuk i ka arsyetuar rregullat e përgjithshme për zbutjen e dënimit në kuptim edhe të neneve 71 dhe 72 të KP-së, në raport me veprën penale nga neni 267 par.1 të KPRK-ës, -për të cilën parashihet dënimi është kumulativ me gjobë dhe me burgim prej 2 (dy) deri 8 (tetë) vjet, ndërsa Gjykata të akuzuarit A.E ia shqipton dënimin unik me gjobë prej 1400 në të cilën dënim me gjobë hynë edhe dënimi i zëvendësuar me gjobë, duke mos dhënë arsyetim në kuptim të neneve 69, 70, 71, 72 të KPRK-ës përkitazi me aplikimin e rregullave të përgjithshme për matjen dhe zbutjen e dënimit si dhe kufijtë e zbutjes së dënimit, për arsye të lartçekura ka propozuar si me lartë.

Në ankesë mbrojtësi i të akuzuarit A.E, av.Gentian Krasniqi ka theksuar se shkeljet esenciale të dispozitave të procedurës penale neni 384 par.1 pika 1.10 dhe par.2 pika 2.1 dhe 2.7 në lidhje me nenin 242 par. 2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 të KPPK-së. Sipas nenit 384 par.1 pika 1.10 - aktgjykimit të kontestuar, konsideron se i mungon plotësisht arsyetimi. Gjykata në arsyetim nuk ka paraqitur arsyet për dispozitivin e aktgjykimit. Gjykata e shkallës së parë nuk ka arritur që të arsyetojë qartë dhe në mënyrë të plotë dispozitat e caktuara të së drejtës materiale ndaj të akuzuarit dhe veprës penale objekt i aktakuzës;

Sipas nenit 384 par.2 pika 2.1 dhe 2.7 në lidhje me nenin 242 par.2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3 - Gjykata ka zbatuar gabimisht dispozitat e Kodit të Procedurës Penale të Kosovës konkretisht nenin 242 par.2 pika 2.1, 2.2 dhe 2.3, për faktin se i pandehuri fajësinë e ka pranuar për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPK-së si rezultat i premtimeve për dënim të favorshëm

dënim i cili mund të zëvendësohet me dënim me gjobë, në të kundërtën nuk do ta kishte pranuar fajësinë për këtë veprë penale e cila është objekt i akuzës. Ka shtuar se sipas mbrojtës se pranimi i fajësisë së të pandehurit nuk mbështetet në faktet dhe provat e çështjes që përmban aktakuza, pasi që me asnjë provë materiale dhe personale nuk mund të vërtetohet fakti dhe qëllimi që i pandehuri ka pasur për qëllim që narkotikun të ua shesë të tjerëve apo ofrojë për shitje;

I pandehuri siç ka deklaruar në Polici po ashtu edhe në Prokurori, pohon se është e vërtetë që ka poseduar narkotikë të cilin e ka blerë për vete për konsumim personal, mirëpo nuk ka pasur kurrfarë qëllimi që të ua shesë të tjerëve shpërndajë apo ofrojë për shitje. Fakti se i pandehuri nuk e ka pranuar vullnetarisht fajësinë për vapën penale objekt i akuzës nga neni 267 par. I të KPK-së, dhe se këtë veprë e ka pranuar vetëm në seancë gjyqësore pasi që i është premtuar dënim i favorshëm nëse pranohet fajësia, vërtetohet në bazë të kërkesës për negociimin e pranimi fajësisë të cilën i pandehuri nëpërmjet mbrojtësit të tij i kishte parashtruar prokurorit të shtetit me dt.14.12.2023 duke kërkuar nëpërmjet saj që mund të negociojmë pranimin e fajësisë për veprën penale “Posedimi i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotropike ose anologe nga neni 269 par.1, të KPK-së e jo për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPK-së, për arsye të lartcekura ka propozuar si me lartë.

### Vlerësimi i Gjykatës së Apelit

Gjykata e Apelit, vlerëson se pretendimet e lartë cekura ankimore nuk qëndrojnë e as që ka shkelje të tjera të dispozitave të procedurës penale, për të cilat, sipas detyrës zyrtare kujdeset kjo gjykatë, e të cilat do të kishin kushtëzuar anulimin e aktgjykimit të ankimuar.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar aktgjykimin e ankimuar sipas pretendimet ankimore të mbrojtëses, por edhe sipas detyrës zyrtare, vlerëson se si njëjti nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, ngase dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, në të nuk ka kundërtënie me vetveten e as me arsyet e tij, është i qartë dhe konkret. Aktgjykimi i kundërshtuar përmban arsyet e duhura mbi të gjitha faktet relevante të kësaj çështje penale.

Prandaj nuk janë të pa bazuara pretendimet ankimore të mbrojtësit se gjykata e shkallës së parë të ka bërë shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, pasi që i akuzuari e ka pranuar fajësinë nga neni 269 par.1 e jo për veprën penale nga neni 267 par.1 të KPK-së.

Fillimisht vlen të theksohet se sipas procesverbalit të shqyrtim fillestar të datës 04.03.2024 procedura në këtë çështje penale është zhvilluara sipas proceduarve të parapara ligjore për shqyrtim fillestar

Duke ju referuar procesverbalit të datës 04.03.2024 kolegji gjen se i akuzuarit në shqyrtim fillestar për mbrojtës ka pasur të angazhuar avokatin Gentian Krasniqi i caktuar sipas detyrës zyrtare (tani avokatin që ka ushtruar ankese), gjithashtu nga procesverbali i shqyrtimit fillestar rezulton se i akuzuari pas njoftimit nga ana e kryetares të trupit gjykues është njoftuar për të drejtat e tij, se mund të deklarohet lidhur me rastin, po ashtu mund të deklarohet edhe lidhur me pranimin e fajësisë e cila do të konsiderohet rrethanë lehtësuese në rastin e marrjes se dënimit, mirëpo ajo nuk e përjashton mundësinë nga përgjegjësia penale dhe se i pandehuri nuk ka të drejtë ta ankimoj aktgjykimin për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plot të gjendjes faktike, po ka të drejtë të parashtron ankesë lidhur me bazat tjera, për të cilat nuk është i kënaqur dhe atë për vendimin mbi dënim, shpenzimet e procedurale etj. Pas kësaj të pandehuri i është lejuar kontakti me mbrojtësin e tij në lokalet e veçanta të gjykatës.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, dhe pas konsultimit me mbrojtësin e tij i pandehuri është deklaruar se e ka të qartë aktakuzën dhe se e pranon fajësinë për veprën penale me të cilën ngarkohet. Po ashtu pas deklarimit të pakurorit se nuk e kundërshton pranim e fajësisë pasi që kjo është bërë në pajtim me dispozitat ligjore, pas konsultimeve të mjaftueshëm me mbrojtësin e tij, pastaj edhe mbrojtësi i të pandehurit av.Gentian Krasniqiu, ka deklaruar se pajtohem me deklarimin e të mbrojturit tim lidhur me pranim e fajësisë, duke konsideruar se gjykata në rastin e marrjes se vendimit lidhur me shqiptimin e sanksionit penale mund të këtë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese që shkojnë në favor të pandehurit, andaj edhe i ka propozuar gjykatës që me aktvendim ta aprovoj pranim e fajësisë, me çka gjykata edhe ka vepruar konform nenit 248 par.1 dhe 2 të KPRK-së.

Për rrjedhojë, në rastin konkret nuk qëndrojnë pretendimet e mbrojtës se gjatë kësaj procedura i pandehuri apo mbrojtësi ta kenë kundërshtuar cilësimin juridik të veprës penale nga dispozita e nenit 267 par.1 të KPRK-së në veprën e penale nga neni 269 par.1 të KPRK-së, nga rrethanat e çështjes një pretendim i tillë rezulton të jetë i supozuar, por jo edhe i kundërshtuar nga ana e mbrojtës apo të pandehurit gjatë procedimit të shqyrtimit fillestar në deklarimin rreth pranimin të fajësisë, prandaj nga kjo rrjedh se vendimi i shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm.

Pretendimet ankimore të Prokurorisë lidhur me vendimin mbi dënim

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet ankimore të Prokurorit për shqiptimin e dënimit me të ashpër janë të bazuara. Gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të dënimit i ka mbivlerësuar rrethanat lehtësuese, duke i përcaktuar të akuzuarit dënim nën minimumin ligjor prej gjashtë (6) muaj burgim dhe më pas të njëjtin dënim e ka zëvendësuar në dënim me gjobë në lartësi prej një 1000 (njëmijë ) euro, dhe me dënimin me gjobë në lartësi prej 400 € (katërqind euro). Në pajtim me nenin 76 par.1 dhe 2 nën par.2.4 të KPRK-së, i ka shqiptuar dënim unik me gjobë në lartësi prej 1400 € (njëmijë e katërqind euro).

Kolegji vlerëson se dënimi i shqiptuar nuk është proporcional me peshën konkrete të veprës penale, rrethanave të kryerjes, të akuzuarit i'u kanë gjetur .... qese të najllonit substancë narkotike të llojit marihuanë me peshë neto ..... gram si dhe një pako me rizlla "...", edhe përkundur ekzistimit të rrethanës veçanërisht lehtësuese pranimin fajësisë, dënimi i shqiptuar është i pamjaftueshëm për të arritur qëllimin ndëshkimor në kuptim të preventivës speciale dhe asaj gjeneralë, andaj konform këtyre rrethanave e dënimi i caktuar prej tetë (8) muaj burgim është proporcional dhe në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë së veprës së kryer penale, shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit, dhe me intensitetin e rrezikimit apo pasojave të shkaktuara dhe se me të do të mund të parandalohet i akuzuari nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, si dhe do të parandalohen personat tjerë nga kryerja e veprave penale, ndërsa dënimi me gjobë prej 400 (katërqind) euro merret si i vërtetuar.

Nga arsyet e sipër cekura, e në bazë të nenit 403 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA E APELIT E KOSOVËS**

**PAKR.nr.272/24**

**Datë: 28.05.2024**

**Bashkëpunëtorja Profesionale**

**Kryetari i kolegjit**

\_\_\_\_\_  
**Syzana Goxhuli**

\_\_\_\_\_  
**Vaton Durguti**

**Anëtarët e kolegjit:**

\_\_\_\_\_  
**Bashkim Hyseni**

\_\_\_\_\_  
**Kadrije Goga- Lubishtani**